



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. i Br. / No.	2173	Nr. ifaq/ Br. str / No. pg	18
Dati / Datum / Date:		21.09.2022	
		Pojë / Pec	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

UDHËZUES PËR PROGRAMË TË STUDIMIT


Shtator 2022

Përbajtja

1. Inicimi i programeve të reja	3
1.1. Detyrat e propozuesve	4
1.2. Niveli i kualifikimit dhe ECTS sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, 2020	5
1.2.1. Niveli Bachelor	6
1.2.2. Niveli Master	7
1.2.3. Niveli i Doktoratës	8
1.2.4. Kriteri i hulumtimit shkencor për bartësit e programeve bachelor dhe master:	9
2. Hartimi i programeve të studimit	10
2.1. Dokumentet për hartim të programeve	11
2.2. Aprovimi i programeve	12
3. Monitorimi i zbatimit të programit të studimit	13
3.1. Detyrat e përgjegjësve për monitorimin e programeve të studimit	13
3.1.1. Monitorimi i bartësve të programit	13
3.1.2. Monitorimi i stafit akademik, bartësit të lëndës, sipas planprogramit të akredituar	13
3.1.3. Monitorimi i orareve të ligjératave dhe ushtrimeve	14
3.1.4. Monitorimi i implementimit të rekomandimeve të ekspertëve	14
3.1.5. Monitorimi i web faqes	14
3.1.6. Kontrollimi i planprogramit sipas akreditimit nga KSHC	15
3.1.7. Monitorimi i vijueshmërisë së mësimit	15
3.1.8. Monitorimi i punës praktike	15
4. Vlerësimi i programeve të studimit	16
5. Rishikimi i programeve të studimit	17

Ky udhëzues është pjesë përbërëse e Rregullores për Programe të Studimit, i cili zbërthen procedurat e inicimit, hartimit, aprovimit, monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit, dhe është obligues për të gjitha palët e parapara në rregullore dhe udhëzues.

1. Inicimi i programeve të reja



1.1. Detyrat e propozuesve

Çdo propozues i paraparë në nenin 3 të kësaj rregullore, për iniciimin e një programi të ri të studimit ka për detyrë që:

- Të hulumtojë tregun e punës;
- Të ketë takime me trupat këshillëdhënës dhe palet tjera të interesit;
- Të bëj analiza të ndryshme përmes pyetësorëve apo fokus grupeve;
- Te analizojë se a ka programe të ngjashme që ofrohen në Kosovë;
- Te hulumtojë se a ofrohen programe të ngjashme në universitetet relevante evropiane (krahasueshmëria).

Formulari i cili duhet plotësuar me informacione rreth programit të studimit të propozuar, i cili duhet të i dorëzohet Këshillit të njësisë akademike për aprovim:

Emri i institucionit:	
Fakulteti:	
Emri i programit të studimit:	
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	
ECTS:	
Specializimet:	
Kodi i Zonës së Subjektit Erasmus (ESAC):	
Numri i vendeve të studimit/Kuota:	
Qëllimi i programit:	
Misioni (Programi i inicuar duhet të jetë në harmoni me misionin e UHZ-së dhe të njësisë akademike dhe organizative përkatëse):	
Përbajtja e programit:	
Rezultatet e të nxënët (të paktën 7):	
Të sigurojë që ekzistojnë bartësit e kualifikuar të fushës përkatëse, dhe të kenë publikime shkencore të indeksuara, sipas kërkesës së AKA-së (emrat e bartësve)	

Bashkë me tabelarin, Këshillit të njësisë akademike propozuesit e programeve të studimit duhet t'i bashkangjesin edhe këto dëshmi:

- Dëshmi mbi hulumtimin e tregut të punës;
- Prosesverbale dhe lista e nënshkrimeve nga takimet me trupat këshillëdhënës dhe palet tjera të interesit;
- Rezultate nga analiza të ndryshme përmes pyetësorëve apo fokus grupeve;
- Dëshmi se a ka programe te ngjashme që ofrohen ne Kosovë;
- Dëshmi se a ofrohen programe të ngjashme në Universitetet relevante evropiane (krahasueshmëria).

Inicuesit duhet të i dorëzojnë propozimet për programe të reja më së largu 45 dite para hapjes se afatit per aplikim ne AKA.

Procedurat e njëjta të lartëcekura vlejnë edhe për programet të cilat aplikohet për riakreditim.

1.2. Niveli i kualifikimit dhe ECTS sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, 2020

Korniza e Kualifikimeve Kombëtare		
Niveli i KKK	Përmban kualifikime të shoqëruara me Programet e arsimit	Niveli referues i KEK
	Kualifikimet aktualisht në dispozicion (Lloji)	
8	Arsimi i lartë - cikli i 3-të i Bolonjës (Doktorata)	A 8
7	Arsimi i lartë - cikli i 2-të i Bolonjës (Master)	A 7
6	Arsimi i lartë - Cikli i 1-rë i Bolonjës (Bachelor)	A 6

Niveli 6 përfshinë programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm Bachelor. Gjithashtu, janë parashikuar edhe kualifikimet e fituara pas përfundimit të trajnimeve të cilat deri tani nuk janë në KKK.

Niveli 7 përfshinë programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm Master. Gjithashtu, janë parashikuar edhe kualifikimet e fituara pas përfundimit të trajnimeve të cilat deri tani nuk janë në KKK.

Niveli 8 përfshinë programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm të Doktoratës

1.2.1. Niveli Bachelor

Niveli - Këto diploma janë në nivel të 6 të kualifikimeve në KKK

Vlera e kredive - Kanë vlerë prej 180 deri në 240 kredi ECTS.

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK i demonstrojnë njojuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njojuritë:

Ata duhet të kenë njouri të avancuara në dhe rreth fushës së punës apo studimit, përfshirë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve. Kjo mund të përfshijë:

- përdorimin e njourive të integruara të parimeve, karakteristikave, kufije dhe terminologjisë në kuadër të një lënde, discipline apo fushe të punës për të arritur gjykim të informuar rreth teorive dhe praktikave apo për ta udhëhequr atë;
- shfrytëzimin e njourive të hollësishme dhe të kuptuarit në një ose më shumë specializime, që janë pjesa më e avancuar e një lënde, discipline ose fushe të punës;
- demonstrimin e njourive dhe të kuptuarit e mënyrave të zhvillimit të një lënde, discipline ose fushe të punës, duke përfshirë një radhë të teknikave të përcaktuara të mbledhjes së të dhënave ose metodologjisë së hulumtimit.

Shkathtësitë:

Shkathtësitë praktike të avancuara, njoħe se dhe kreative.

Ata do tē janë në gjendje ta demonstrojnë mjeshterinë dhe inovacionin për t'i zgjidhur problemet komplekse dhe tē paparashikuara në fushën e specializuar të punës ose studimit. Kjo mund të përfshijë:

- përdorimin e disa shkathtësive, praktikave dhe materialeve të specializuara dhe të avancuara ose që janë parësore në një lëndë, disciplinë apo fushë të punës;
- ekzekutimin e projekteve të definuara të hulumtimit, zhvillimit për identifikimin dhe zbatimin e rezultateve relevante;
- përcaktimin në një radhë të konteksteve të nivelit profesional, që përfshinë një shkallë të paparashikueshmërisë dhe specializimit, demonstrimin e originalitetit dhe kreativitetit si dhe tē gjykuarit në situata kur tē dhénat/informacionet janë të limituara ose rrjedhin nga burime të ndryshme.

Kompetencat:

Ata do tē realizojnë detyra apo studime, të cilat përfshijnë menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike dhe profesionale, të cilat mund ta përfshijnë përgjegjësinë për vendimmarrje në kontekste të paparashikuara të punës ose studimit, apo ta menaxhojnë zhvillimin profesional të individëve dhe grupeve. Kjo mund të përfshijë:

- punën efektive nën udhëheqje, në bashkëpunim me kolegët e tjerë të kualifikuar;

- ushtrimin e autonomisë dhe iniciativës dhe marrjen e përgjegjësisë kryesore për punën e të tjerëve dhe për një radhë të burimeve;
- bashkëpunimin me të tjerët për të siguruar ndryshime, zhvillim dhe ide të reja;
- marrjen me çështje etike dhe profesionale në pajtim me kodet dhe praktikat ekzistuese profesionale.

1.2.2. Niveli Master

Niveli - Këto diploma janë në nivel të 7 të kualifikimeve në KKK

Vlera e kredive - Kanë vlerë prej 60 deri në 120 kredi ECTS

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstrojnë njojuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njojuritë:

Ata do të kenë njouri shumë të specializuara, të gjera dhe të hollësishme, disa prej të cilave janë themelore në një fushë të punës ose studimit dhe të cilat ndërlidhen me fusha të ndryshme, si bazë për të menduar origjinal dhe hulumtim.

Kjo përfshinë:

- Kuptimin kritik të teorive kryesore, parimeve dhe koncepteve që ndërlidhen me njouri praktike dhe konceptuale të lëndës, disiplinës ose fushës së punës - duke përfshirë specializimet relevante;
- Njojuritë të cilat mbulojnë dhe integrojnë shumicën e fushave kryesore të lëndës, disiplinës ose fushës së punës, përfshirë specifikat dhe terminologjinë;
- Mbështetja në vetëdijen kritike mbi çështjet aktuale të një lende, discipline ose fushe të punës duke përfshirë specializimet përkatëse.

Shkathtësitë

Ata do të jenë në gjendje t'i përdorin shkathtësitë dhe teknikat e specializuara të ndërlidhura me një lëndë apo disiplinë, fushë profesionale, përfshirë edhe aktivitetet të cilat kërkojnë të menduar inovativ dhe kërkime origjinale. Ata do të kenë qëndrim dhe do t'i vlerësojnë informatat e reja, konceptet dhe dëshmitë nga një gamë e gjerë e burimeve dhe duhet të jenë në gjendje t'i përdorin shkathtësitë e specializuara për zgjidhjen e problemeve, për zhvillimin e njourive dhe procedurave të reja dhe integrimin e njourive nga fushat e ndryshme si:

- planifikimin dhe kryerjen e një projekti të rëndësishëm të hulumtimit dhe zhvillimit;
- zhvillimin e përgjigjeve origjinale dhe kreative për problemet dhe çështjet e praktikuara në një shumëlojshmëri të gjerë dhe shpesh të paparashikueshme, në kontekste të ndryshme profesionale;
- hartimin e temës për master.

Kompetencat:

Ata do të janë autonomë dhe do të kenë iniciativë për veprimtaritë profesionale dhe të ngashme, duke marrë përgjegjësinë për punën e vet si dhe për punën e të tjerve. Ata ndërmarrin iniciativa për punë ose studime që përfshijnë menaxhimin dhe transformimin e konteksteve të punës apo studimit, të cilat janë komplekse, të paparashikuara dhe kërkojnë qasje të reja strategjike. Kjo mund të përfshijë:

- menaxhimin e ekipeve profesionale, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive dhe praktikës si dhe shqyrtimin e performancës së tyre;
- trajtimin e çështjeve komplekse etike dhe profesionale dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet të cilat nuk janë të adresuara nga kodet ose praktikat aktuale profesionale.

1.2.3. Niveli i Doktoratës

Niveli - Këto diploma janë në nivel të 8 të kualifikimeve në KKK

Vlera e kredive - Nuk kanë vlerë të përcaktuar të kredive për këto kualifikime.

Individët që i arrijnë kualifikimet në këtë nivel të KKK demonstrojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat si në vijim:

Njohuritë:

Ata do të kenë dhe përdorin njohuri shumë të avancuara në një fushë të punës, studimit apo fushë hulumtuese për ndërlidhjen e fushave të ndryshme, nxjerrjen e përfundimeve përmes rishikimit kritik të një lënde apo discipline, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive, parimeve dhe koncepteve.

Njohuritë dhe të kuptuarit gjenerohen përmes hulumtimit personal apo punës së ngashme që kontribuon në zhvillimin e lëndës apo disiplinës dhe ofron njohuri origjinale dhe kreative si ide dhe informacione për risitë, çështjet komplekse dhe abstrakte, duke zhvilluar qëndrime kreative dhe origjinale ndaj problemeve.

Kjo përfshinë:

- punën për risitë dhe çështje shumë komplekse si dhe të gjykuarit në mungesë të të dhënave apo informacioneve të plota ose të qëndrueshme;
- shtrimin, avancimin apo kundërshtimin e njohurive dhe praktikave profesionale brenda një fushe të caktuar ose ndërlidhjen mes fushave.

Shkathtësitë:

Ata do të janë në gjendje të përdorin një varg të shkathtësive, teknikave, praktikave dhe materialeve të lëndës, disiplinës ose fushës së punës me qëllim të arritjes së njohurive, ideve, informacioneve dhe risive për çështje komplekse dhe abstrakte si dhe zhvillimin e qëndrimeve kreative dhe origjinale ndaj problemeve.

Kjo përfshinë aplikimin e një sërë metodash standarde dhe të specializuara të hulumtimit dhe kërkimit (psh. sintezës dhe vlerësimit) për t'i dizajnuar dhe kryer projektet hulumtuese apo zhvillimore, me qëllim të zgjidhjes së problemeve kritike dhe shtrimin, avancimin apo kundërshtimin e njohurive apo praktikës profesionale, duke kontribuar për njohuri të reja brenda një disipline apo fushe arsimore. Kjo mund të përfshijë:

- rishikimin e literaturës, eksperimentimin dhe krijimin e qasjeve të tjera për një varg çështjesh;
- punime shkencore, shkrime dhe vështrime kritike, zhvillime inovative në një apo më shumë fusha të specializimit ose fushave kërkimore;
- përgatitja e tezës së doktoratës.

Titulli i të tri niveleve duhet ta përbajë emrin dhe llojin e kualifikimit, nivelin dhe fushën e studimit (psh. fusha e arteve, shkencave, inxhinierisë, drejtësisë, hulumtimit) dhe fusha kryesore të studimit.

Shembull: Bachelor i Arteve në Politikë dhe Ekonomi, Bachelor i Shkencave të Aplikuara në Bujqësi, Master i Arteve në Administrim Biznesi, Master i Kërkimeve në Psikologji Sociale, Doktor i Inxhinierisë, etj.

1.2.4. Kriteri i hulumtimit shkencor për bartësit e programeve bachelor dhe master:

Përveç kritereve të përcaktuara me UA për Akreditim, bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit, riakreditimit ose validimit në nivelin BA/BSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike Prof. Ass. dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 WEB OF SCIENCES koleksioni bërtname (SCIE, SSCI dhe AHCI) apo 1.2 SCOPUS, duke përashtuar revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI.


2. Hartimi i programeve të studimit



Detyrat Bartësit të programeve të studimit	Detyrat e Grupit punues i formuar nga Këshilli i njësisë akademike
<ul style="list-style-type: none">• Udhëheqin me grupin punues për hartimin e programit;• Analizojnë nevojat e tregut për programin në hartim;• Marrin pjesë në hartimin e pritjeve mësimore (learning outcomes);• Përcaktojnë raportin e lëndëve të obligueshme dhe zgjedhore në program;• Hartojnë tabelarët me përbajtje të programit sipas standardeve ECTS, të ndërlidhura me pritet mësimore;• Organizojnë mësimdhënësit potencial që të hartojnë përbajtjet e syllabuseve;• Deri në ditën e vlerësimit nga ekspertët e jashtëm ndërkombëtar, bartësit e programit janë të obliguar të mbajnë simulime me grupe pjesëmarrëse të cilët do të marrin pjesë në takim me ekspertë.	<ul style="list-style-type: none">• Përcaktohen me vendim në momentin e themelimit

2.1. Dokumentet për hartim të programeve

Hartuesit e programit të studimit u përbahen dokumenteve aktuale në fuqi, të brendshme dhe të jashtme, si në vijim:



Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, të gjitha plotësim ndryshimet e akteve ligjore, nënligjore, manualeve, apo dokumenteve tjera të nxjerra nga MASHT, AKA, UHZ, e të cilat e rregullojnë këtë fushë, bartësit e programit janë të obliguar të i respektojnë si të ishin paraparë në këtë rregullore.

2.2. Aprovimi i programeve

Aprovimi i programeve të uhz-së, bëhet si më poshtë

Aprovimi i brendshëm (nga organet e UHZ-së)

Organet e brendshme:

1. Këshilli i njësisë akademike
2. KMCV (organ rekomandues i Senatit)
3. Senati

Senati është organi i fundit vendimarrës për aprovim apo jo të programeve të studimit në aplikim, e cila është fazë e tretë dhe e fundit


E gjithë procedura nga momenti i inicimit e deri në aprovim nga Senati i UHZ-së, duhet të përfundojë më së largu 15 ditë para mbylljes së aplikimit në AKA

Aprovimi i jashtëm (nga Agjensia e Kosovës për Akreditim).

Aprovimi i jashtëm i fazës së parë të programit në aplikim bëhet nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (faqja e parë, shtojcat, bartësit).

Nëse programi është aprovuar, UHZ duhet të hartojë programin e studimit brenda 30 ditëve, dhe ta dorëzojë në AKA.

3. Monitorimi i zbatimit të programit të studimit



3.1. Detyrat e përgjegjësve për monitorimin e programeve të studimit

3.1.1. Monitorimi i bartësve të programit

Monitorimi i bartësve të programit bëhet çdo tre muaj nga Koordinatorët/Zyrtarët e Cilësisë në njësi akademike, duke verifikuar nëse bartësit janë akoma staf i rregullt i institucionit. Koordinatorët/Zyrtarët obligohen të njoftojnë Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë, dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në rast të largimit të bartësit të programit të studimit nga njësia akademike, më së largu 10 ditë pas datës së largimit të bartësit. Njësia akademike (institucioni) obligohet të bëj zëvendësimin e bartësit të programit të studimit me një bartës tjetër, më së largu 80 ditë pas datës së largimit të bartësit paraprak, i cili formalisht plotëson kriteret e përcaktuara.

3.1.2. Monitorimi i stafit akademik, bartësit të lëndës, sipas planprogramit të akredituar

Monitorimi i stafit akademik dhe bartësit të lëndës bëhet nga Bartësit e programit të studimit, në fillim të çdo semestri, duke bërë krahasimin e përputhshmërisë së të dhënave të paraqitura në RVV me orarin e publikuar të ligjëratave dhe ushtrimeve. Monitorimi i stafit akademik dhe bartësit të lëndës bëhet me qëllim përfshirja e siguruar se njësia akademike është duke ofruar programin e studimit me stafin akademik ashtu siç është paraqitur në raportin e vetëvlerësimit. Në rast se bartësit e programit vërtetojnë se stafi akademik në bazë të së cilët programi është ri/akredituar, nuk janë prezent në njësi akademike dhe të njëjtë nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me institucionin, bartësit njoftojnë Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë, dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, dhe kërkojnë nga Dekani dhe Prodekani për Mësim të bëjnë zëvendësimin e stafit akademik me kualifikime të ngjashme sikurse stafi paraprak. I gjithë procesi duhet të realizohet në 10 ditëshin e parë të çdo semestri.

3.1.3. Monitorimi i orareve të ligjératave dhe ushtrimeve

Monitorimi i orarit të ligjératave dhe ushtrimeve bëhet nga Koordinatorët/Zyrtarët e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Prodekanin për Mësim, në fillim të çdo semestri (dhe në vazhdimësi). Monitorimi i orareve dhe ligjératave bëhet me qëllim për të siguruar përputhshmërinë e planprogramit të akredituar sipas Raportit të Vetëvlerësimit sipas Manualit të Akreditimit (lëndët obligative dhe zgjedhore, fondi i orëve të ligjératave dhe ushtrimeve, puna praktike si dhe bartësin e lëndës përkatëse) me orarin e ligjératave dhe ushtrimeve të publikuar në web. Në rast se vërtetohet se stafi akademik nuk janë prezent në ligjérata/ushtrime/punë praktike, dhe se procesi mësimor nuk është mbajtur në përputhje me fondin e orëve të paraqitura në RVV, Koordinatorët/Zyrtarët/Prodekanët për Mësim njoftojnë Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombetar dhe Ngritje të Cilësisë, dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, dhe kërkojnë nga Dekani që orët e humbura mësimore të zëvendësohen nga stafi sipas planprogramit.

3.1.4. Monitorimi i implementimit të rekondimeve të ekspertëve

Plani për implementim të rekondimeve përmban një elaborim përbajtësor, i bazuar në dëshmi dhe në planifikim real se cilat veprime i ndërmerr njësia akademike për të adresuar rekondimet e ekspertëve. Plani për implementim të rekondimeve përmban: Rekondimet e epikës së ekspertëve; Mekanizimi/Instrumenti; Matja; Individu përgjegjës; Afati kohor; dhe Komente shtesë, ndërsa Progresi, në baza semestrale nga momenti i dorëzimit të planit në AKA, do të monitorohet nga bartësit e programit dhe koordinatorët/zyrtarët e cilësisë një njësi akademike.

Në rast se rekondimet nuk janë implementuar sipas afatit të paraparë bartësit dhe koordinatorët/zyrtarët njoftojnë Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombetar dhe Ngritje të Cilësisë, dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim dhe sugjerojnë Dekanin që të merr masa për implementim sipas afateve të parapara.

3.1.5. Monitorimi i web faqes

Monitorimi i web faqes me qëllim të sigurimit se janë publikuar për secilën njësi akademike informacione të qarta, të sakta, objektive, relevante, të arritshme dhe të detajuara në lidhje me:

- Stafin akademik;
- Veprimtaritë kërkimore dhe akademike;
- Programet që ofrohen;
- Rezultatet e pritshme të mësimit të programeve, kualifikimet që ata i japin, procedurat mësimdhënies, të mësimit dhe të vlerësimit të përdorura;
- Numrin e studentëve të regjistruar;
- Normat e kalueshmërisë dhe mundësitet e mësimit për studentët;
- Informatat e diplomimit dhe të punësimit;
- Mundësitet e bursave, si dhe
- Pagesat për shkollim dhe taksat administrative;
- Rezultatet e vlerësimit nga pyetësorët e brendshëm;
- Rregullore dhe dokumente tjera relevante, etj.

Monitorimi i web faqes bëhet në baza mujore dhe në vazhdimësi nga koordinatorët/zyrtarët për sigurim të cilësisë, dhe nëse të dhënat përkatëse nuk janë publikuar, kërkojnë të dhënat nga personat përgjegjës dhe i dërgojnë të IT për publikim në ueb të njësisë akademike përkatëse.

3.1.6. Kontrollimi i planprogramit sipas akreditimit nga KSHC

Kontrollimi i planprogrameve bëhet nga Koordinatorët/Zyrtarët për Sigurim të Cilësisë, çdo fillim semestri, duke krahasuar planprogramin sipas RVV-së së ai/akredituar me planprogramin e publikuar në web të njësisë akademike, me qëllim të verifikimit nëse është duke u zhvilluar plaprogrami i njëjtë. Nëse ndonjë emërtim i lëndës në planprogramin e publikuar nuk përkon me planprogramin e RVV-s, Koordinatorët/Zyrtarët për Sigurim të Cilësisë njoftojnë Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë, dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, ndërsa Zyra kërkon arsyeshmëri nga njësia akademike.

3.1.7. Monitorimi i vijueshmërisë së mësimit

Monitorimi i vijueshmërisë së mësimit bëhet nga Bartësi i programit të studimit/Shefi i programit në bashkëpunim me Prodekanin për Mësim. Vijueshmëria e mësimit do të bëhet në baza javore, ndërsa në fund të muajit përgjegjësit për monitorimin e vijueshmërisë do të hartojnë raport në lidhje me mbajtjen e mësimit nga stafi akademik (katërmbëdhjetë javë për semestr) dhe vijueshmërinë e mësimit nga studentët (numri pjesëmarrës i studentëve në ligjérata/ushtrime). Raportet nga monitorimi i dërgohen Prorektorit për Çështje Mësimore dhe Kërkime Shkencore, Zyrës për Çështje Akademike, Koordinatorit/Zyrtarit të Cilësisë në njësi akademike.

3.1.8. Monitorimi i punës praktike

Monitorimi i punës praktike të studentëve bëhet nga bartësi i lëndës, i cili mbështetet nga Zyrtari për Zhvillim të Karrierës, në baza semestrale (përcjellë vijueshmërinë e praktikës nga fillimi i semestrit, dhe raporton në përfundim të semestrit). Raportet dhe formularin e vijueshmërisë së praktikës e dorëzojnë të Zyra për Zhvillim të Karrierës. Pjesë e monitorimit është edhe personi i caktuar nga institucioni ku mbahet praktika.

4. Vlerësimi i programeve të studimit

Vlerësimi i programit të studimit bëhet nga komisioni ad-hoc në nivel të NJA. Komisioni ad-hoc ka si detyrë kryerjen e vlerësimit të programit dhe hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Vlerësimi i programit do të bëhet pas çdo dy viteve me kusht që gjatë monitorimit të jetë çdo gjë në rregull.



Vlerësimi i programeve të studimit mund të bëhet, por pa u kufizuar, nëpërmjet:

- Pyetësorëve me studentë, alumni, punëdhënës, etj;
- Fokus grupeve;
- Analizimit të statistikave për fushat përkatëse të programit, dhe vlerësimeve të tjera, të cilat janë paraparë në Rregulloren për Programe të Studimit.


Vlerësimi i programeve të studimit (të cilat synojnë përi akreditim) bëhet (pas çdo dy viteve, para përfundimit të semestrit të katërt për programet 120, 180, 240 ECTS, ndërsa për programet 60 ECTS, para përfundimit të semestrit të dytë), në periudhën kohore 1 maj – 1 korrik, ndërsa dorëzimi i raportit me rezultate të vlerësimit bëhet deri me 1 shtator.

5. Rishikimi i programeve të studimit

Rishikimi i Programeve bëhet me propozim nga:	
Komisioni ad-hoc pas vlerësimit të programit të studimit	KMCV

Akterët që mund t'i propozojnë KMCV-së në çdo kohë formimin e komisioneve ad-hoc për vlerësim që shpije deri te Rishikimi i Programeve të Studimit janë:

- Rektori;
- Senati;
- Udhëheqësi i programit të studimit;
- Dekani i njësisë përkatëse;
- Këshilli i njësisë akademike.



Universiteti mund të kryejë ndryshime në nivelin e një programi studimi brenda kufirit prej 35%. Ndryshimet që tejkalojnë këtë përqindje përbëjnë një program të ri dhe prandaj do të kërkohet që t'i nënshtronen një procedure të re akreditimi.

Grupi punues, në afat prej 30 ditë, programin e rishikuar dhe të përmirësuar duhet ta dërgojë në Këshillin e njësisë akademike.